




Nr. i faq.
Data

2
30/09/2020

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK



Kuvendi i Komunës

Nr. 002/18

Datë: 29.09.2020

Në bazë të nenit 61 paragrafi 2 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Ligji Nr. 03/L-048); nenit 40 paragrafi 2 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 21 paragrafi 21.1 pika e) të Statutit të Komunës së Junikut dhe nenit 19 paragrafi 15 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur me 29.09.2020 nxjerrë:

V E N D I M

për miratimin e Buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2021

I. Me këtë vendim miratohet Buxheti i Komunës së Junikut për vitin 2021 i propozuar nga Kryetari i Komunës së Junikut, dhe Korniza Afatmesme Buxhetore 2021-2023.

II. Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Junikut për vitin 2021 është: **1,546,704.00 €** dhe është i shpërndarë në linjat buxhetore si në vijim:

1. Stafi për vitin 2021, është **163 punëtorë**.
2. Kategoria Paga dhe mëditje për vitin 2021, është : **1,147,799.00 €**
3. Kategoria Mallra dhe shërbime për vitin 2021, është **172,900.00€**
4. Kategoria e Shpenzimeve komunale për vitin 2021, është **36,200.00 €**
5. Kategoria e Subvencioneve për vitin 2021, është **30,500.00 €**
6. Kategoria e Shpenzimeve kapitale për vitin 2021, është **159,305.00€**

Totali i Buxhetit të aprovuar për vitin 2021, është 1,546,704.00 €

III. Për zbatimin e këtij vendimi respektivisht ekzekutimin e buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2021 sipas linjave buxhetore nga pika II e këtij vendimi është përgjegjës Kryetari i Komunës së Junikut.

IV. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen vendimet tjera me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

V. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

VI. Vendimi iu dërgohet:

1. Ministrisë së Pushtetit Lokal,
2. Ministrisë së Financave dhe Transfereve,
3. Kryetarit të Komunës,
4. Shërbimit të Kuvendit të Komunës së Junikut,
5. Arkivës të Komunës së Junikut.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Muharrem Krasniqi

